



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.392/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj -kryesues, Bujar Muzaqi dhe Kymete Kicaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga kandidatja për Kuvendin e Komunës së Prishtinës, nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokrate, Besjana Canolli, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura në 12 Tetor 2025, me datë 05.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.392/2025, datë 04.11.2025, e parashtruar nga kandidatja për Kuvendin e Komunës së Prishtinës, nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokrate, Besjana Canolli, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 01/3093-2025 të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura në 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 04.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatës për Kuvendin e Komunës së Prishtinës, nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokrate, Besjana Canolli me të cilën deklaroi se ka mungesë të votave në disa qendra votimi, të cilat nuk përputhen me dëshmitë dhe informacionet të cilat i posedon. Qendrat e votimit si Shkolla "Gjergj Fishta" ku sipas rezultateve zyrtare figuron me vetëm 6 vota, ndërkohë që posedon dëshmi (kopje të letërnjoftimeve dhe deklarime) nga disa familjarë dhe miq që e kanë votuar, ndërsa numri ishte dukshëm më i lartë. Në Shkollën "Shkëndija" figurojnë 5 vota, ndërsa posedon dëshmi nga persona të shumtë që e kishin votuar. Fakulteti i Edukimit, mungon një votë me kusht, për të cilën pretendon se ka dëshmi se është në favorin e saj. Me tutje thekson se ka mospërputhje në numërimin dhe evidentimin e votave të cilat e dëmtojnë drejtësinë dhe transparencën e procesit zgjedhor. Andaj, kërkon nga PZAP-i që të verifikohet procesi i numërimit të votave në qendrat e votimit të përmendura në ankesë, të bëhet rinumërimi dhe krahasimi i votave, si dhe të ndryshohet rezultati përfundimtar në përputhje me të dhënat reale.

Ankuesja ka paraqitur si dëshmi (kopje të letërnjoftimeve të votuesve që deklarojnë se kanë votuar për të).

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 05.11.2025, ka deklaruar/sqaruar se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN.

Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatate Zgjedhore sipas dispozitës së nenit 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV.

Me tutje, KQZ deklaroi se procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar.

Pala ankuese, ndër të tjera ka pretenduar se disa nga familjarët, votues kanë votuar për të, mirëpo sipas saj mungojnë votat e tyre. Ky pretendim nuk mund të vërtetohet, pasi që vota është e fshehtë dhe në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës, dhe po ashtu në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit.

Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, po ashtu nuk ka bashkangjitur prova relevante, që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e saj.

KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë kamerat e sigurisë, Librat e Votimit dhe Formularët) gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë konstaton se:

- Ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e ankuesës për Kuvendin e Komunës së Prishtinës, nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokrate, Besjana Canolli, janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara si në ankesë se ka mospërputhje të numrit të votave sipas deklaratave të dëshmitarëve (familjarë), paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e saj, kjo pasi që paraqitësja e ankesës nuk ka bashkangjitur prova me të cilat do të argumentonte pretendimet e tij se i mungojnë votat, ndërsa pretendimet e theksuara në ankesë tani për tani mbeten në nivel të supozimit nga se nuk janë argumentuar me fakte dhe në prova konkrete. Po ashtu Paneli vlerësoi se në rastin konkret kopjet e letërnjoftimeve të votuesve që deklarojnë se kanë votuar për parashtruesen e ankesës nuk mund të merren si prova të besueshme dhe të bazuara për faktin se nuk mund të vërtetohet në asnjë formë se votuesit përkatës të kenë votuar për kandidatin e caktuar përkatësisht

parashtruesen e ankesës për shkak se asnjë fletëvotim nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesja e ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, andaj duke u mbështetur në nenin 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku përcaktohet se: *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesja e ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.392/2025 më datën 05.11.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.